

Ministri serb Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Dacic ka deklaruar se Spanja nuk do të ndryshojë qëndrim lidhur me mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës, sado që ka thënë se ka presion ndaj pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë këtë.

Duke komentuar deklaratën e komisarit të ri evropian për fqinjësi Johanes Han “se pesë anëtare të BE që nuk e kanë njohur Kosovën kanë treguar njëfarë lëkundjeje”, Dacic ka thënë se Han “nuk do t’i frikësojë këto pesë shtete” dhe se ka “ka shumë kërcënues seriozë që bëjnë presion ndaj tyre”. “Ato pesë që shtete s’e kanë njohur Kosovën kanë mjaft probleme, por nga ana tjetër edhe e gjithë Europa dhe bota do të ketë mjaft probleme pse kanë pranuar disa parime të shpalljes së njëanshme të pavarësisë “, ka thënë Dacic.